

URDHËR¹
Nr. 1051, datë 21.10.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 402, DATË 30.9.2021,
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR HARTIMIN E PLANIT PËR
DETYRIMIN E ZBARKIMIT TË HEDHURINAVE TË DISA FORMAVE TË
PESHKIMIT FUNDOR NË DET”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 98, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në Rregulloren “Për hartimin e planit për detyrimin e zbarkimit të hedhurinave të disa formave të peshkimit fundor në det”, të miratuar me urdhrin nr. 402, datë 30.9.2021, “Për miratimin e rregullores “Për hartimin e planit për detyrimin e zbarkimit të hedhurinave të disa formave të peshkimit fundor në det”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Neni 4 shfuqizohet.
2. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 1, fjalët “*Si përjashtim i nenit 4 të kësaj rregulloreje ...*” shfuqizohen.
 - b) Shkronja “a”, e pikës 1, riformulohet si vijon:
“a) Merluci (*Merluccius merluccius*) dhe barbuni (*Mullus spp.*), maksimum 5% të zënieve totale vjetore të këtyre specieve për anijet fundore.”
 - c) Në shkronjën “dh”, të pikës 1, maksimumi i zënieve prej “3%” zëvendësohet me “2%”.
 - ç) Pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f”, me përmbajtje si vijon:
“f) Skampi (*Nephrops norvegicus*), maksimum 1% të zënieve totale vjetore të kësaj specie për anijet që përdorin kurthe.”
3. Pas nenit 5 shtohet neni 6 me përmbajtje si vijon:

“Neni 6

Monitorimi dhe grumbullimi i të dhënave për hedhurat

1. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës monitoron dhe grumbullon të dhëna mbi hedhurinat për speciet të listuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje.
 2. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës përgatit në bazë vjetore një raport mbi respektimin e sasive minimale të lejuara për speciet e listuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, totalin vjetor të hedhurinave për anijet që përdorin rrjeta fundore, njica dhe mrezha, si edhe totalin vjetor të hedhurinave sipas specieve.
 3. Raporti dorëzohet brenda datës 28 shkurt të vitit pasardhës te drejtoria përgjegjëse për peshkimin në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.
 4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dhe inspektorati që mbulon fushën e peshkimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

¹ “Përafruar pjesërisht me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2023/2918, të datës 22 gusht 2023 që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1380/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, sa i përket vendosjes së një përjashtimi të sasive minimale të detyrueshme për zbarkim për disa specie fundore në detin Adriatik dhe në detin Mesdhe juglindor” Nr. Celex 32023R2918, datë 28.12.2023.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla